

STRATEGJIA PER
ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL

PËR

KOMUNËN E SUHAREKËS

2021 - 2026

Contents

HYRJE	3
Përmbledhje e përgjithshme	3
Profili komunal	4
Përshkrimi.....	4
Demografia	5
Ekonomitë familjare	5
Të dhëna statistikore	6
Të dhëna socio ekonomike	6
Arsimi:.....	7
Ekonomia	7
Infrastruktura	8
Energjia elektrike	9
Mbështetja për Zhvillimin e Bujqësisë	9
Telekomunikacioni / Teknologjia e Komunikimit Informativ (TIK)	10
Mbështetja për Zhvillimin e Turizmit:	11
Çështje të përgjithshme	12
Analiza SWOT e hisedarëve dhe pikëpamjet e tyre	13
Plani i veprimit – përshkrimi.....	15
Plani i Veprimit - tabela	19
Grupi i punës	26

HYRJE

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal (SZHEL) është dokument të cilin komuna e Suharekës, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile kanë punuar së bashku përmes së cilës do të krijohen kushte më të mira për rritjen ekonomike dhe gjenerimin e punësimit në komunë. Qëllimi i SZHEL është të ndërtojë kapacitetin ekonomik lokal të komunës së Suharekës, duke përmirësuar kështu të ardhmen e saj ekonomike dhe cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët.

SZHEL është përqendruar në rritjen e konkureshmërisë komunale, rritjen e qëndrueshme dhe sigurimin që rritja të jetë gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, SZHEL përfshin edhe ndërtimin e forcës ekonomike të komunës tonë duke optimizuar burimet dhe kapacitetet lokale, palët e interesuara ekonomike në qytet dhe fshatra duke rritur rëndësinë e identifikimit dhe hapjes së mundësive të biznesit, mbështetjes së iniciativave të ndërmarrjeve, duke lehtësuar hyrjen në treg dhe krijimin e një klime të favorshme për investime dhe aktivitete biznesi. SZHEL do të kontribuojë edhe në dimensionin ekonomik edhe në dimensionin social, politiko-administrativ, mjedisor dhe atë kulturorë.

Sipas Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë 2016-2026¹ ku flitet për zhvillimin e politikave efektive për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike lokale, thuhet se komunat duhet të jenë konkurrense ndërmjet vete për të rritur mundësinë e tyre për të tërhequr sa më shumë fonde nga donatorët. Kështu, SZHEL krijon sistemin për investime kapitale si dhe adresimin e çështjeve të zhvillimit ekonomik lokal përmes hartimit të politikave strategjike gjithëpërfshirëse për zhvillimin ekonomik lokal dhe institucionalizimin dhe sistemimin e politikave zhvillimore lokale. Për të pasur këtë qasje sistemore, është hartuar kjo strategji zhvillimore për zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë kuadër, aftësimi i të rinjve dhe fuqizimi i grave është një komponentë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik lokal. Rritja e kapaciteteve profesionale të tyre, sidomos sa i përket çështjes së ndërmarrësisë dhe aftësimin e tyre se si t'i qasen themelimit dhe funksionimit të biznesit, duke marrë në konsideratë resurset natyrore të zonave të caktuara rurale dhe urbane në komuna, zhvillimin e turizmit rural, veprimtaritë që kanë të bëjnë me prodhimin në agrikulturë dhe plasimin e këtyre produkteve në treg janë disa nga parametrat që do të ndikojnë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik lokal. Përmes programeve tematike, SZHEL në bashkëpunim me komunitetin lokal do të krijoj mundësi trajnimi në fushën e zhvillimit socio-ekonomik. Përmes skemave stimuluese për të rinjtë dhe gra do t'u jepet mundësia që të kenë qasje në tregje për të shitur mallrat dhe shërbimet. Gjithashtu hartimi i skemave programore për punësimin e të rinjve dhe grave në sektorë me prioritet mundëson uljen e papunësisë dhe rritjen e zhvillimit ekonomik lokal. Mbështetja e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), zhvillimi i sektorit të bujqësisë, turizmi dhe energjia e ripërtitshme janë ndër kriteret kryesore për zhvillimin e ekonomik lokal të komunës së Suharekës. Skemat e grandeve për mbështetje të bizneseve, krijimi i mekanizmave për të stimuluar bizneset dhe produktet vendore do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Përmbledhje e përgjithshme

Puna rreth Strategjisë së parë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal është iniciuar më 6 nëntor 2020, pas kërkesës nga ana e drejtorisë për Administratë, drejtori Driton Maliqaj dhe drejtori për Financa Agim Bylykbashi si dhe Ekipit Komunal për Projekte Komunale (ERPK) drejtuar Agjencisë për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR Jug) për hartimin e kësaj strategjie. Pas këtij takimi, u hartua plani i veprimit i procesit të hartimit të SZHEL-it. Ky plan parasheh të gjitha aktivitetet nga mbledhja e të dhënave socio-ekonomike

¹ http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_per_veteqeverisje_lokale_shq_ser_ang.pdf

nga ana e ERPK, punën drejt themelimit të grupit të punës, i cili përfaqëson të gjitha grupet e hisedarëve në procesin zhvillimor. Ky grup u themelua vendim të Kryetarit të komunës së Suharekës z. Bali Muharremaj, i datës 1 dhjetor 2020 me numër protokolli 01-Nr.-410-57529. Grupi i punës është i përbërë nga 18 anëtarë dhe është i ndarë në katër grupe tematike:

1. Ndërmarrësia
2. Turizmi
3. Agrikultura
4. Ambienti dhe energjia e ripërtitshme

Kapacitetet për hartimin dhe zhvillimin e strategjive për zhvillim ekonomik lokal në komuna janë ende të kufizuara. Komuna e Suharekës dhe AZHR Jug së bashku me partneritetin e zhvilluar ndër vite do të koordinojnë hartimin e SZHEL, do të punojnë në mobilizimin e fondeve qeveritare dhe donatore të tjerë si kusht për zbatimin efikas të dokumentit. Sipas kornizës ligjore të Kosovës dhe praktikave më të mira të Bashkimit Evropian (BE), SZHEL do të:

- fokusohet në kontekstin e saj ekonomik dhe social
- krijon një vizion për zhvillim të ardhshëm të komunës së Suharekës
- angazhon hisedarët në mënyrë të hapur dhe produktive
- komunikon mesazhet qartë dhe saktë
- identifikon mekanizma të zbatimit të planit të veprimit
- projektet i ndan në faza të ndryshme të zbatimit
- jetë mjetë fikas për monitorim dhe vlerësim

Kjo strategji përfaqëson një përpjekje në procesin e vazhdueshëm për zhvillimin lokall në të ardhmen. Ajo mund t'i nënshtrohet përmirësimit të mëtejshëm dhe përditësimit si rezultat i rritjes së kapaciteteve komunale por edhe si rezultat i procesit të monitorimit dhe vlerësimit. Për më shumë, procesi është i bazuar në tre parime themelore që reflektojnë praktikën më të mira në fushën e planifikimit të zhvillimit lokal:

1. Zhvillimi ekonomik lokal do të angazhojë një partneritet të gjerë komunal, që përfshin qeverinë komunale, hisedarët nga komuniteti i biznesit (sektorin publik dhe privat) dhe OJQ – të.
2. Qasja ndaj zhvillimit lokal “nga poshtë - lartë”, që nënkupton përfshirjen e hisedarëve lokal në identifikimin e projekteve të komunale dhe
3. Zhvillimi lokal i hartuar në strategji si një proces i integruar.

Profili komunal

Përshkrimi

Komuna e Suharekës gjendet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit, Malishevës, Lipjanit, Shtimes, Ferizajt dhe Shtërpçës. Shtrihet në gjerësi gjeografike veriore prej 42°15' – Parku Nacional “Sharri” (jugu), 42°30' – Malet e Berishës dhe Javori (veriu). Gjatësia gjeografike lindore: 20°45' - komuna e Rahovecit (perëndim), 21°00' - Malet e Jezercit, Guri i Dellocit (lindje). Komuna e Suharekës është e rrethuar me male të larta dhe atë në veriperëndim me malet e Pagarushës dhe të Temeqinës me lartësi mbidetare prej 796 deri 828 m, në veri me ato të Carralevës 922 deri 1048m, në lindje me malet e Jezercit 1,677 m (Kryet e Ahishtës) dhe në jug-lindje me malet e Sharrit 2,092 m (Dera e Pashës) derisa në perëndim shtrihet rrafshina (ultësira) e Prizrenit. Lartësia mesatare mbidetare në komunë është 455m. Sipërfaqja e kësaj komune është 361.78 km² (që mbulon 3.3 % të

territorit të Kosovës. Nga sipërfaqja e komunës (prej 36,099 ha) 15,074 ha ose 41.7% janë të mbuluara me pyje, 19,373 ha ose 53.7% janë tokë bujqësore dhe 1,652 ha ose 4.6% sipërfaqe tjetër. Komuna e Suharekës kufizohet me një perimetër prej 105.24 km, dhe atë me komunën e Prizrenit - 19.36 km; Mamushës - 5.66 km; Rahovecit - 6.49 km; Malishevës - 25.38 km; Lipjanit - 5.70 km; Shtimes - 25.60 km; Ferizajit - 8.48 dhe Shtërpces - 14.23 km.

Demografia

Komunën e Suharekës, si njësi territoriale, e përbëjnë: qyteti i Suharekës, lagjet urbane dhe fshatrat. Territori i Komunës përfshin 43 vendbanime, përfshirë Suharekën dhe këto vendbanime: Bllacë, Budakovë, Bukosh, Breshanc, Delloc, Dobërdelan, Dragaqinë, Dubravë, Duhël, Dvoran, Greikoc, Greiçec, Gelancë, Gjinoc, Javor, Kastërc, Krushicë e Epërme, Krushicë e Poshtme, Leshan, Luzhnicë, Maqitevë, Mohlan, Mushtisht, Neprebisht, Nishor, Papaz, Peqan, Popolan, Qadrak, Reshtan, Reqan, Savrovë, Samadrexhë, Sallagrazhdë, Semetisht, Sllapuzhan, Sopijë, Stravuçinë, Studençan, Tërnje, Vërshëc dhe Vraniç.

Sipas të dhënave të fundit zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, regjistrimit të vitit 2011, komuna e Suharekës ka 43 vendbanime me gjithsej 59,722 banorë, me dendësi banimi prej 165 banorë/km² në një sipërfaqe prej 361.78 km². Lartësia mesatare mbidetare e komunës është nga 455 m deri në 1760 m.

Ekonomitë familjare

Sipas të dhënave që bazohen në regjistrimin e fundit zyrtar të vitit 2011, 9145 ekonomi familjare. Komuna e Suharekës ka 1,803 ekonomi familjare në zonën urbane dhe 7,342 ekonomi familjare në zonën rurale, pra gjithsej ka 9,145 ekonomi familjare. Sipas tabelës së mëposhtme janë të paraqitura karakteristikat demografike komunale:

	Zonë urbane	Zonë rurale	Gjithsejtë
Ekonomitë familjare	1,803	7,342	9,145
Numri i banorëve	10,422	49,300	59,722
Numri mesatar i banorëve në një ekonomi familjare	5.78	6.71	6.53
Femra	5,268	24,976	30,244
Numri mesatar i femrave në një ekonomi familjare	2.92	3.40	3.31
Meshkuj	5,154	24,324	29,478
Numri mesatar i meshkujve në një ekonomi familjare	2.86	3.31	3.22

Trendi i ekonomive familjare në zonat urbane dhe në ato rurale gjatë 8 viteve të fundit është drejt rritjes. Në zonat urbane kemi rritje rreth 160% ndërsa në zona rurale është rreth 33%. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 vërehet një dallim i vogël gjinor, ku 30,244 banorë janë të gjinisë femërore ose 50.64% ndërsa 29,478 banorë janë meshkuj ose 49.36%. Po sipas këtij regjistrimi, ndarja sipas grup moshave duket kështu:

Grup moshë	20-64 vjeç	5-14 vjeç	15-19 vjeç	0-4 vjeç	≥ 65 vjeç
Numri i banorëve	31,743	12,211	6,466	5,198	4,104
% e banorëve	53.15%	20.45%	10.83%	8.70%	6.87%

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, komuniteti shqiptar dominon me gjithsejtë 98.92% , komuniteti ashkali me 0.83% dhe ai romë me 0.07% .

Numri dhe përqindja e banorëve sipas komuniteteve duket kështu:

Komuniteti	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Tjerë
Banorë	59100	4	15	41	493	5	0	15	49
%	98.96%	0.01%	0.03%	0.07%	0.83%	0.01%	0.00%	0.03%	0.08%

Të dhëna statistikore

Numri sipas gjinisë dhe nacionalitetit (urban/rural)

Urban			Rural		
M/F	M/F	M/F	M/F	M/F	M/F
Shqiptar	RAE	Të tjerë	Shqiptar	RAE	Të tjerë
5.154/5.268	539	36	24.324/24.976	N/A	N/A

Mosha (grup moshat)

0-18		19-65		65<	
M	F	M	F	M	F
9.038	8.371	15.281	16.462	1.844	2.260

Norma e rritjes dhe zbritjes/nataliteti dhe mortaliteti

N 673 /M 275

Shkalla e parashikuar e rritjes

2007-83.300, 2011-88.181, 2017-86.973

Dendësia e popullsisë

165 banorë/km²

Të dhëna socio ekonomike

Punësimi:

Punonjësit sipas aktivitetit industrial

- Ndërmarrjet sipas sektorit ekonomik 2019
- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi 18
- Xehoret dhe gurëthyesit 7
- Industria përpunuese 35
- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim 1
- Furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese 1
- Ndërtimtaria 18

- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave 37
- Transporti dhe magazinimi 8
- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit 31
- Informimi dhe komunikimi 2
- Aktivitetet financiare dhe të sigurimit 3
- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike 11
- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse 13
- Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obligativ 1
- Arsimi 3
- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale 2
- Arte, argëtimi dhe rekreacioni 7
- Aktivitetet tjera shërbyese 9

Struktura e grup moshës së të punësuarve dhe ndarja e profesionit të të punësuarve dhe të papunëve (të ndara sipas gjinisë):

	M		F	
	Të punësuar	Të papunësuar	Të punësuar	Të papunësuar
Grup moshë 18-35	6,666	8,937	1,377	18,363

Arsimi:

Numrat dhe llojet e shkollave, numrat e mësuesve (ekuivalent me kohë të plotë) dhe madhësitë e klasave.

Rrjeti i objekteve shkollore përbëhet prej 1 çerdheje, 28 shkollave të nivelit Fillor dhe të Mesëm të Ulët dhe në 3 shkolla të nivelit të Arsimit të Mesëm të Lartë. Numri i përgjithshëm i mësimeve është 786 mësime/e dhe 38 edukatore.

Ekonomia

Numri dhe madhësitë e bizneseve, të ndara sipas sektorëve numrin e punonjësve ekuivalentë me kohë të plotë, në seri kohore, nëse është e mundur

Biznese Individuale B.I. 2.494;

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar SH.P.K. 667;

Ortakëri e Përgjithshme O.K. 31;

Shoqëri Aksionare SH.A. 8;

Kooperativa Bujqësore K.P. 2.

Numri dhe lloji i mbylljes së firmave të fundit (p.sh. 5 vitet e fundit), sipas madhësisë, sektorit dhe datës

Numri i bizneseve të shuara për vitin 2019 është: 64

Numri i bizneseve të reja, sipas madhësisë, sektorit / aktivitetit dhe jetëgjatësisë

Numri i bizneseve të reja të regjistruara për vitin 2019 është:

- B.I. - 1.109
- SH.P.K. - 730
- K.B. – 57
- SH.A. – 11
- Dega në Kosovë – 1

1. Transporti Rrugor i mallrave – 560;
2. Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore – 506;
3. Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani – 411;
4. Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionim të ajrit – 317;
5. Tregtia me shumicë jo e specializuar – 310;
6. Punime suvatimi – 302;
7. Aktivitetet shërbyese të pijeve – 299;
8. Instalime të tjera ndërtimore – 291;
9. Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave – 279;
10. Instalime elektrike – 277.
11. Të ardhurat nga taksa e biznesit
12. Të ardhurat nga taksa e biznesit janë: 220.000 € – 240.000 €.

Infrastruktura

Gjendja e furnizimit me ujë, energji elektrike dhe ujëra të ndotura në fushat e veprimtarisë ekonomike

Kapacitete ekzistuese eksploatuese janë burimeve ujore është 0.17 m³/s, gjersa 0.121 m³/s aktualisht shfrytëzohen për furnizim.

Sipërfaqësorë (m ³ /s)	Nëntokësorë (m ³ /s)	Eksploatuese (m ³ /h)	Furnizuese (m ³ /s)	Rezervuarët (m ³ /s)
0.127	0.802	626.4	0.121	7.245

Vendbanime/Banorë me qasje në rrjetë të ujësjellësit	Numër	%
Vendbanime		<u>43</u>
Banorë (rezident dhe jo rezident)		<u>93,316</u>
Vendbanime me rrjet të ujësjellësit	<u>21</u>	<u>48.8%</u>
Vendbanime me rrjet të ujësjellësit funksional dhe pjesërisht funksional	<u>18</u>	<u>41.9%</u>
Vendbanime nën menaxhim të KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A	<u>14</u>	<u>32.6%</u>
Banorë që kanë qasje në rrjet të ujësjellësit	<u>70,927</u>	<u>76.0%</u>
Banorë që kanë qasje në rrjet të ujësjellësit funksional dhe pjesërisht funksional	<u>60,196</u>	<u>64.5%</u>

Banorë që kanë qasje në rrjet të ujësjellësit funksional dhe pjesërisht funksional nën menaxhim të KRU 53,066 56.9%

Prej tyre 7 vendbanime ose 41% furnizohen me ujë nga burimet (me anë të gravitacionit), kurse 11 vendbanime ose 59% furnizohen me ujë me anë të sistemit të pompave që rrit koston e mirëmbajtjes për m³ të ujit të harxhuar.

Ujerrat e Zeza:

Rrjeti i kanalizimit në qytetin—Pjesa më e madhe e qytetit të Suharekës ka sistem të kanalizimit fekal dhe atmosferik. Rrjeti i kanalizimit fekal është i shpërndarë në shumë (L=8.096m), gjersa të gjithë ujërat e zeza, pa përjashtim, shkarkohen në lumit të qytetit, në Toplugë. Shkatërrimi bëhet pa ndonjë trajtim paraprakë duke e ndotur ujin e lumit.

Rrjeti i kanalizimit në fshatra—Vetëm 11 ose 23% të fshatrave kanë rrjet të kanalizimit fekal, gjersa pjesa tjetër e fshatrave 30 ose 63 % nuk kanë rrjet të kanalizimit. Grupi i dytë i fshatrave, shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë numër gropa klasike, nëpër jaze ose kanale sipërfaqësore, kurse shtëpitë ose grup shtëpisë që kanë afër lumenj shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë drejtpërdrejt në lumë pa ndonjë trajtim paraprak.

Ujerrat e Ndotura:

Lidhur me ujin e pijes disa vendbanime kanë probleme sepse nuk kanë qasje në sistemin e ujësjellësit dhe ujin e pijes e marrin nga pusët individuale apo kolektive, të cilat shpesh nuk mirëmbahen si duhet. Këto puse nuk janë të ndërtuara si duhet dhe ndodh të ndoten nga ujërat sipërfaqësor (si ujëra të zeza apo të kulluara) gjë që përbën një rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e popullatës. Në komunën e Suharekës 40% e banorëve kanë qasje në ujësjellës dhe në sistemin e kanalizimit janë të kyçur 45% e banorëve.

Ujërat të përdorura nga larja e hapësirave të ndryshme, ujërat e zeza (fekale) duhet të derdhën në rrjetin e kanalizimit. Ujërat e të reshurave atmosferike nga sipërfaqet e kulmeve të objekteve afariste dhe objekteve individuale dhe kolektive si dhe sipërfaqet tjera të grumbullohen dhe të derdhën në kanalën e veçantë të ujërave atmosferike.

Energjia elektrike

Qyteti i Suharekës me rrethinë furnizohet nga nënstacioni NS Suhareka 110/35/10(20) kV nga dy transformator me fuqi totale të instaluar prej $2 \times 31.5 = 63$ MVA ku:

T1-110/35/10 kV me fuqi 31.5 MVA

T2-110/10(20) kV me fuqi 31.5 MVA

Kostoja e shërbimeve (ujë, energji elektrike, mbledhja e mbeturinave) 0.67 Euro m² uji - krahasim me të tjera komuna

Mbështetja për Zhvillimin e Bujqësisë

Sipërfaqet e disponueshme për mbjellje është 16,568/ha, sipërfaqet e mbjella janë 12,666/ha, kulturat e mbjella dhe sasi të tyre drithëra 4,481/ha, vreshta 949/ha, perime 646/ha dhe pemë 279/ha, disponueshmëria e ujitjes, rrugëve nga ferma në treg, numri i blegtorisë (bagëti të mëdha 7,943 krerë lopë

qumështorë dhe 11,298 viçave dhe mështjerrave, dhe ato të vogla ku janë 34 ferma të deleve me kapacitet 30 – 400 krerë dele, pra numri i përgjithshëm i deleve është 2,700 krerë. Dhe kemi 14 ferma të Dhive me kapacitet prej 20 – 100 krerë dhi, numri i përgjithshëm është 344 krerë dhi) sisteme të avansuara në përdorim (diellore, erë etj), sistemet e kullimit dhe bllokimit të ujit, tregjet / terminalët ushqimorë

Telekomunikacioni / Teknologjia e Komunikimit Informativ (TIK)

Rrjeti i ekzistues i kabllove optike i cili është i shtrirë në relacionin:

Shtime-Duhel-Suharekë-Prizreni.

Duhet të zgjerohet duke implementuar projekte të zhvillimit të kësaj rrjete në drejtimet përkatëse:

Duhel-Bllacë-Malishevë.

Suharekë-Reshtani-Studenica-Samadrexhë.

Suharekë -Shirokë-Sopi-Dubravë-Mushtisht.

Suharekë-Peqan

Topliqan-Terrnje.

Gjithashtu në këtë kuadër duhet të parashihet shtrirja e kabllove optike deri në të gjitha lokacionet e komunës së Suharekës ku do të mundësoj qasjen e të gjithë aktoreve ashtu që:

Mundësia e operimit me shërbimet e internetit të çdo shkolle, kabineteve të informatikës

Shërbimi FTTH për secilën shtëpi për shërbime përkatëse

Lidhja e qendrave(bashkësive) lokale me Kuvendin Komunal, zyrave të ofiqarive etj.

Lidhja e ambulancave lokale me qendrat përkatëse të mjekësisë.

Lidhja e shërbimeve të emergjencave, stacioneve policore, gjykatave, stacioneve të furnizimit me ujë, infrastrukturës sportive etj., duke mundësuar integrimin e rrjetit për qëllime publike.

Përmes projekteve përkatëse për përmirësimin e shërbimeve dhe ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore do të realizohet ofrimi i shërbimeve telekomunikuese duke përfshi shërbimet:

Voice-telefoni fikse,

Data- internet dhe

TV- televizionin me teknologji IPTV.

Këto shërbime do të ofrohen përmes brezit të gjerë ku si medium transmetues do të shfrytëzohet fibri optik i shtrirë kryesisht nëpër gypa plastik dhe kanale nëntokësore sipas parametrave teknik duke siguruar qasje dhe leje nga organet përkatëse komunale.

Fuqia e brezit të gjerë të telefonisë

Sa i përket telefonisë fikse, dhe në përgjithësi infrastrukturës së telekomunikacionit, gjendja në komunën e Suharekës është shumë e keqe. Vendbanimet e vetme që kanë qasje në shërbimet e rrjetës së telefonisë fikse janë:

Suhareka me 1130 numra telefonik,

Mushtishti me 250 numra telefonik;

Samadrexha me rrjet të ri të telefonisë fikse.

Ky kapacitet është i vogël sepse vetëm rreth 45% të banorëve të Suharekës dhe dukshëm më pak se 27% të banorëve të Mushtishtit kanë rrjete të telefonisë fikse. Rrjeti ekzistues i Telefonisë Fikse i cili siç u tha është i shpërndarë vetëm në lokalitetet e lartpërmendura, duhet të përmirësohet dhe kompletohet me qellim që t'i ofroj shërbimet përkatëse në ato lokalitete si dhe të instalohen në ato tjerat ku nuk ekziston.

Mbështetja për Zhvillimin e Turizmit:

Resurset natyrore dhe vendet turistike:

- Bjeshka e Mushtishtit
- Guri i Dellocit – Guri i livadheve
- Bjeshka e Bukoshit
- Bjeshka e Budakovës
- Buqalla – Suharekë
- Burimi i ujit mineral - Reçan
- Rezervati natyror i Rusenicës
- Parku Natyror Rahavan
- Lisi në Bllacë
- Parku Kombëtar i Malit Sharr
- Resurset kulturore
- Biblioteka komunale;
- Katër (4) Qendra Rinore;
- Muzeu i qytetit;
- Objektet turistike
- Hisari – Suharekë
- Tumat Ilire – Gjinoc
- Kalaja e Kastërcit
- Kulla e Ramë Bllacës
- Mulliri i ujit – Qadrak
- Mulliri i ujit – Buzhalë
- Trashëgimia kulturore (e prekshme dhe shpirtërore)
- E Prekshme:
- Kisha e Virgjëreshës se Shenjte në Hodegetri, Mushtisht
- Kisha e Shën Gjergjit, Reçan
- Manastiri i Treshit të Shenjte, Mushtisht
- Gërmadhat e murgores në kodrën e Matos, Mushtisht
- Gërmadhat e murgores Rusenica, Mushtisht
- Rrënojat e kishës mesjetare në Mushtisht
- Kështjella - Qyteti i Grajqevcit, Grajqevc
- Shkolla fillore - Muzeu, Suharekë
- Mulliri i Berishëve, Suharekë
- Xhamia e Bardhe, Suharekë

- Tyrbe Lezi, Suharekë
- Mulliri i familjes Loshi, Vraniq
- Mulliri i familjes Bytyqi, Semetisht
- Mulliri i familjes Bytyqi, Breshanc Suharekë
- Mulliri i vjetër i familjes Buzhala, Buzhalë
- Mulliri i vjetër i Elez Ramë Buzhalës, Buzhalë
- Xhamia e Budakovës, Budakovë
- Kulla e Jonuz Hasan Tafollit, Qadrak
- Xhamia e fshatit *, Semetisht
- Xhamia e Gazi Mehmed Pashës, Leshan
- Shtëpia e Xhevdet Gashit, Dubravë
- Shtëpia muze e Fadil Vatës, Sallagrazhdë

Shpirtërore:

- *Dita e Viktimave të Luftës*
- *Dita e çlirimit të Suharekës*
- *Festa e Rinisë “Festari”*

Çështje të përgjithshme

Promovimi i interesave të përbashkëta

Parimet themelore që janë të shprehura në Strategjitë e mëparshme të Rajonit Ekonomik Jug, si dhe fushat prioritare, të zhvillimit rajonal, ku komuna e Suharekës, në të njëjtën kohë do të ishte edhe konkurruese, por edhe do të ishin fusha prioritare për të mundësuar një fokusim më të mirë të përpjekjeve strategjike në çështjet që janë parë si drejtuesit e zhvillimit të rajonit, janë:

Përqendrimi në zhvillimin ekonomik. tërë rajoni Jug, duke pasur parasysh, edhe infrastrukturën rrugore (rruga kombëtare/Auto udha dhe pozita e saj strategjike, dhe infrastrukturën biznesore (një zonë ekonomike gati me infrastrukture të përfunduar – potencial edhe për dy zona tjera ekonomike, për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal).

Çështjet e ndërthurura. Çështjet sociale, kulturore, sportive; trajtohen si çështje të ndërthurura dhe janë të pranishme në të gjitha fushat e strategjisë dhe të programimit. Këto përfshijnë parimin e mundësive të barabarta për grupet e pa favorizuara (të rinjve, grave, minoriteteve etnike dhe personat me aftësi të kufizuara). Përveç kësaj, ekzistojnë çështje sociale, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të cilat gjithashtu duhet të merren në konsideratë. Një shembull i këtyre do të ishte përmirësimi i arsimimit të përgjithshëm si dhe atij profesional si dhe bazën e aftësive të popullatës punuese.

Mbrojtja e ambientit. Partnerët /konkurrentet të zhvillimit duhet perceptuar çështjet e mjedisit si çështje me karakter të ndërthurur. Ata duhet të marrin në konsideratë çdo sektor të zhvillimit. Më konkretisht, aspektet që partnerët e zhvillimit kanë miratuar në fushën e mjedisit dhe qëndrueshmërisë përfshijnë: ruajtjen dhe promovimin e bio-diversitetit; mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit natyror; reduktimin e niveleve të ndotjes; minimizimin e gjenerimit të mbeturinave dhe rritjen e efikasitetit të energjisë.

Krijimi i mirëqenies. Për momentin, përpjekjet strategjike janë të përqendruara në nxitjen e zhvillimit të ekonomisë së rajonit, apo ndryshe thënë krijimin e mirëqenies dhe prosperitetit. Fokusimi parësor nuk është në rishpërndarjen e pasurisë. Përfshirja është përpjekja në rishpërndarjen gjeografike përmes identifikimit, si dhe realizimit të potencialit ekonomik të lokacioneve të ndryshme brenda rajonit, si kontributi i tyre drejt

Analiza SWOT e hisedarëve dhe pikëpamjet e tyre

Fuqitë	Dobësitë
Toka bujqësore pjellore; Kushtet e përshtatshme klimatike-tokësore; Pozita gjeografike; Kushtet e mira për zhvillimin e agroturizmit; Arsimimi i mesëm profesional bujqësor; Tradita në prodhimtarinë bujqësore dhe blegtorale; Eksportimi i prodhimeve bujqësore (pemë dhe perime) në tregun evropian; Ekzistimi i depove për grumbullim dhe ruajtje të pemëve dhe perimeve; Qasje e lehtë në treg; Teknologjia për përpunimin e rrushit-verës dhe përpunim të pemëve; Zyra këshillimore për bujqësi, me ofrim të shërbimeve cilësore për fermerë; Fermat komerciale; Produkte cilësore bujqësore; Tradita e kultivimit të hardhisë dhe rritja e kultivimit të saj; Përvojë e mirë në industrinë e drurit, metalit dhe ind. ushqimore; Fuqia punëtore e kualifikuar dhe me moshë të re (kualifikimi kryesor në sektorin e ndërtimtarisë); Pozita e volitshme gjeografike (qasja e lehtë në treg); Zonat ekzistuese ekonomike; Shkolla të arsimit dhe aftësimit profesional; Pasuritë natyrore për zhvillimin e turizmit malor dhe rural; Trashëgimi i pasur kulturor arkeologjik dhe arkitektonik; Muzeu edukativ.	Mungesa e kabineteve profesionale bujqësore; Parcelimi i ngastrave bujqësore në sipërfaqe të vogla; Fuqia punëtore e pamjaftueshme Mungesa e sistemit të ujitjes për tokat bujqësore; Përdorimi i pakontrolluar i pesticideve në mbrojtjen e kulturave bujqësore; Mungesa e infrastrukturës përcjellëse në pemishte intensive për mbrojtje kundër breshrit dhe ngricave të vonshme pranverore (rrjeta speciale); Kapaciteti i prodhuesit i vogël i fermave bujqësore; Mungesa e teknologjisë përpunuese të perimeve dhe produkteve blegtorale; Fonde të pamjaftueshme për mbrojtjen e prodhimeve bujqësore; Mekanizmi bujqësor i vjetruar dhe i pamjaftueshëm; Përdorimi i metodave të vjetra bujqësore; Mungesa e mbajtjes së shënimeve të fermës. Mungesa e stafit të Teknologjisë Informative; Mungesa e trajnimeve; Mungesa e data bazës së bizneseve; Mungesa e një strategjie zhvillimore ekonomike; Mungesa e shënjimit të aseteve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore; Mungesa e hulumtimeve të reja arkeologjike; Infrastruktura e pazhvilluar turistike; Mungesa e materialeve promovuese të turizmit; Mungesa e guidave; Mungesa e vendeve rekreative dhe parkingjeve; Mosshfrytëzimi i burimeve ujore; Mosmiratimi i planeve të hollësishme

	rregullative; Mungesa e komunikimit (koordinimit) në mes të komunës dhe sektorit privat; Mungesa e infrastrukturës ligjore.
Mundësitë	Kërcënimet
Zona rurale të përshtatshme për kultivimin e vreshtave, perimtarit, pemëtarit dhe blegtorit; Kapacitete ujore të mjaftueshme; Investime të vazhdueshme në infrastrukturën rrugore fushore; Zhvillimi i agroturizmit; Pikat grumbulluese dhe përpunuese për produktet bujqësore; Pyllëzimi i tokave të zhveshura bujqësore – pyjore; Rrjetëzimi i fermerëve mes shoqatave dhe shfrytëzimi i teknologjisë informative; Funksionimi i OJQ-ve bujqësore; Agrozona si mundësi për ngritje të kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese; Shfrytëzimi i fondeve komunale, qendrore dhe të jashtme për ngritjen e fermave të reja dhe shtimin e kapaciteteve përpunuese. Tërheqja e investimeve të huaja; Përmirësimi i infrastrukturës së zonave ekonomike me grande qeveritare dhe të donatorëve të jashtëm; Hapja e zonës së re ekonomike në Duhël; Zhvillimi i investimeve përmes PPP; Themelimi i inkubatorit të biznesit; Përfshirja e diasporës në gjetjen e tregjeve të eksportit dhe promovimin e produkteve lokale; Skemat e grandeve vendore dhe ndërkombëtare për biznese; Përkrahja e startup-ëve dhe artizanateve; Lirimi nga taksat komunale; Politikat e favorshme komunale për zhvillim të turizmit; Rritja e ofertës turistike; Hartimi i planeve rregulluese hapësinorë; Përgatitja e fletushkave për nxënës për orientim në karrierë.	Fatkeqësitë elementare natyrore, si breshëri, ngricat e vonshme pranverore, vërshimet, thatësira ekstreme; Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore; Politika jo të favorshme ekonomike-fiskale dhe për mbrojtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale; Degradimi i pyjeve nga dëmtuesit ilegal; Uzurpimet e tokave bujqësore-pyjore; Konkurrenca jolojale në treg; Kreditë me kushte të pavolitshme; Kostoja e lartë e energjisë elektrike dhe shërbimeve të kyqjes; Ekonomia joformale; Emigrimi për shkak të shkallës së lartë të papunësisë; Struktura e bizneseve me orientim joprodhues; Mungesa e investimeve të huaja direkte (FDI); Mungesa e politikave stimuluese për sektorët me interes; Gërmimet klandestine; Ndotja dhe dëmtimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore; Ndryshimi i rrjedhës së lumenjve; Gjuetia ilegale; Mungesa e eksploatimit të pasurive nëntokësore; Mungesa e interesimit të rinjve për drejtimet bujqësore; Mungesa e sigurimeve bujqësore.

Plani i veprimit – përshkrimi

Prioriteti 1 – Zhvillimi i qëndrueshëm i agrikulturës

Objektivi – Kultivimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore

Objektivi	Kategoria dhe titulli i projektit	
Prodhimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore	5.1.1 Pemët, perimet dhe vreshtaria	
	5.1.1.1 „Ngritja e 30 Serave”	
	5.1.1.2 „Furnizim me material fidanor në pemëtari dhe vreshtari	
	5.1.2 Silvi-Kultura (Pyllëzimi me bagrem dhe pishë)	
	5.1.2.1 „Furnizim me material fidanor, (50% bagrem dhe 50% pishë)”	
	5.1.3 Bimët Aromatike	
	5.1.3.1 „Furnizim me pajisje për kultivim, bluarje, terje dhe paketim të bimëve aromatike dhe frutave të malit”	
	5.1.4 Bletaria	
	5.1.4.1 „Furnizim me koshere dhe pajisje për bletari”	
	5.1.5 Blegtoria	
	5.1.5.1 „Ndërtim dhe furnizim me material ndërtimor për shtalla blegtorale/lopë qumështore”	
	5.1.6 Shpeztaria	
	5.1.6.1 „Ndërtim dhe riparim të fermave në shpeztari –furnizim me material ndërtimor dhe pajisje për shpeztari”	
	5.1.7 Agro-Përpunimi i produkteve bujqësore	
	5.1.7.1 „Furnizim me pajisje për përpunim të pemëve dhe perimeve”	
	5.1.7.2 „Furnizim me pajisje për përpunim të qumështit dhe mishit”	
	5.1.7.3 „Ndërtimi dhe furnizimi me pajisje i mini podrumëve për përpunimin e rrushit” (verëra dhe raki)	
	5.1.7.4 “Themelimi i qendrave për grumbullim të pemëve dhe perimeve”	
	5.1.8 Mekanizëm Bujqësor	
	5.1.8.1 „Furnizim me mekanizëm bujqësor”	
	5.1.9 Marketing	
	5.1.9.1 “Promovimi më i mirë i fermerëve në treg”	
	5.1.9.2 “Organizimi i panairit vjetor bujqësor”	
	5.1.10 Certifikim	
	14.Aftësimi dhe certifikimi i fermerëve në standardet ndërkombëtare	
Gjithsej	Gjithësej vlera e projekteve	3,890,000 €

5.2 Prioriteti 2

Objektivi – Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit

Objektivi	Kategoria dhe titulli i projektit	
Zhvillimi i Turizmit	5.2.1 Dokumente strategjike	
	5.2.1.1 “Hartimi i planit strategjik zhvillimor të Turizmit (2021-2025)”	
	Infrastruktura	
	5.2.2.1 “Identifikimi dhe rregullimi i mullinjëve të vjetër në Vraniç, Çadraq, Semetisht, Dragaqine”	
	5.2.2.2 “Identifikimi dhe aftësimi i shtëpive për bujtina potenciale”	

	5.2.2.3 “Hapja e rrugës malore bjeshka e Dellocit – Bukosh – Budakovë – Greikoc”
	5.2.2.4 “Hapja e shtigjeve dhe shenjëzimi në Delloc, Gradanc, Budakovë, Mushtisht, Grejkoc”
	5.2.2.5 “Rregullimi infrastrukturës në Delloc për parking të kampshtëpizave”
	5.2.2.6 “Ndërtimi i rrugës Budakovë – Bukosh – Gradanc – Grejkoc (Kabash)”
	Marketing
	5.2.3.1 “Hartimi i materialeve promovuese turistike”
	5.2.3.2 “Zhvillimi i webfaqes dhe promovimi i turizmit në rrjetet sociale”
	5.2.3.3 “Krijimi i qendrës informuese turistike digjitale në qytet”
	5.2.3.4 “Krijimi i një filmi dokumentar për turizëm në Suharekë”
	5.2.3.5 “Themelimi i qendrës për promovimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore (Muzeu Turistik)”
	Ngritja e kapaciteteve humane
	5.2.4.1 “Aftësimi i vendit për kamping veror tek “Gurra e Kadisë”, Budakovë”
	5.2.4.2 “Aftësimi i 3 ciceronëve turistik në komunë”
	5.2.5 Grande
	5.2.5.1 “Mbështetja e zhvillimit të artizanateve/suvenireve”
	GJITHSEJ:
	6,665.000 €

5.3 Prioriteti 3 – Zhvillimi i ndërmarrësisë

Objektivi	Kategoria dhe titulli i projektit
	5.3.1 Dokumentacioni
	5.3.1.1 “Ndërrimi i destinimit të agrozonës në zonë industriale”
	5.3.2 Infrastruktura
Zhvillimi i Ndërmarrësisë	5.3.2.1 “Vendosja e tabelave informuese në zonën industriale”
	5.3.2.2 “Rregullimi i shiritave të gjelbërt në zonën industriale”
	5.3.2.3 “Ndërtimi i inkubatorit të biznesit me showroom në zonën industriale”
	5.3.3 Grande
	5.3.3.1 “Lansimi i skemës së grandeve për agro përpunim dhe deponim”
	5.3.3.2 “Lansimi i skemës së grandeve për mbështetje të bizneseve të riciklimit”
	5.3.4 Ngritja e kapaciteteve humane
	5.3.4.1 “Aftësimi i të rinjve për hartim të projekteve dhe menaxhim të biznesit”

	5.3.5 Marketing
	5.3.5.1 “Organizimi i panairit vjetor”
GJITHSEJ:	
665,000 €	

5.4 Prioriteti 4 - Energjia e ripërtitshme dhe ambienti

Objektivi	Kategoria dhe titulli i projektit
	Kategoria
Energjia e ripërtitshme dhe ambienti	5.4.1 Infrastruktura
	5.4.1.1 “Investimet në energji diellore në shkolla”
	5.4.1.2 “Ndriçimi publik me panele diellore”
	5.4.1.3 “Ndërtimi i liqenit artificial të Dragaqinës”
	5.4.1.4 “Ndërtimi i hidrocentralit në liqenin e Dragaqinës”
	5.4.1.5 “Ndërtimi i turbinave të erës në Budakovë dhe Duhël (rreth 60 turbina)”
	5.4.1.6 “Aplikimi i energjisë diellore në zona industriale”
	5.4.1.7 “Rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumit”
	5.4.1.8 “Ndërtimi i argjinaturave”
	5.4.1.9 “Ndërtimi i parqeve në zona rurale”
	5.4.1.10 “Ndërtimi i 30 mini-impianeteve për trajtimin e ujerave të zeza”
	5.4.1.11 “Krijimi i 20 rezervateve me ujë”
	5.4.1.12 “Identifikimi dhe përgatitja e infrastrukturës për deponi të materialeve interte”
	5.4.2 Marketing
	5.4.2.1 “Organizimi i fushatës së vetëdijesimit për ambientin dhe mbjellja e drunjve dekorativ”
GJITHSEJ:	
146,985,000 €	

Plani i Veprimit - tabela

Objektivi	Kategoria dhe titulli i projektit	Vlera e projektit	Rezultatet pritshme	Burimet e financimit	Zbatuesit	Periudha e zbatimit
Prodhimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore	6.1.1 Hortikultura dhe vreshtaria					
	6.1.1.1 „Ngritja e 30 Serave”	300,000 €	60 persona të punësuar	Ministria e Bujqësisë, Komuna, Donatoret	Ministria e Bujqësisë, Komuna, Fermerët	2021 - 2022
	6.1.1.2 „Furnizim me fidanë për pemëtari dhe vreshtari	300,000 €	100 fermerë përfitues	Ministria e Bujqësisë, Donatoret, Komuna	Drejtoria e Bujqësisë, AZHB, Fermerët	2021 - 2026
	6.1.2 Silvi-Kultura (Pyllëzimi me bagrem dhe pishë)					
	6.1.2.1 „Furnizim me fidanë për bagrem dhe pishë”	420,000 €	Pyllëzimi i 60 ha	Agjencia Pyjore e Kosovës dhe organizatat e ndryshme	Agjencia Pyjore e Kosovës dhe Drejtoria e Bujqësisë	2021 - 2026
	6.1.3 Bimët Aromatike					
	6.1.3.1 „Furnizim me paisje për kultivim, bluarje, terje dhe paketim të bimëve aromatike dhe frutave të malit”	450,000 €	9 fermerë përfitues	Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Bujqësisë dhe Donatorët	Komuna, Fermerët dhe Drejtoria e Bujqësisë	2021 - 2023
	6.1.4 Bletaria					
	6.1.4.1 „Furnizim me koshere dhe pajisje për bletari”	600,000 €	150 fermerë përfitues (25 x 6)	Komuna, Ministria e Bujqësisë, Donatoret	Komuna, Drejtoria e Bujqësisë, Fermerët	2021 - 2026
	6.1.5 Blegtoria					
	6.1.5.1 „Ndërtim dhe furnizim me material ndërtimor për shtalla blegtorale/lopë qumështore”	600,000 €	72 fermerë përfitues (12 x 6)	Ministria e Bujqësisë, Komuna dhe organizatat tjera	Drejtoria e Bujqësisë, AZHB, Fermerët	2021 - 2026
	6.1.6 Shpeztaria					
	6.1.6.1 „Ndërtim dhe riparim të fermave në shpeztari –furnizim me material ndërtimor dhe pajisje për shpeztari”	300,000 €	6 fermerë përfitues, 6 ferma dhe 6 vende pune	Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Bujqësisë	Drejtoria e Bujqësisë, Komuna, Fermeret	2021 - 2022
	6.1.7 Agro-Përpunimi i produkteve bujqësore					

	6.1.7.1 „Furnizim me pajisje për përpunim të pemëve dhe perimeve“	150,000 €	15 fermerë përfitues	Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Bujqësisë dhe Donatorët	Drejtoria e Bujqësisë, Bizneset	2021 - 2023
	6.1.7.2 „Furnizim me pajisje për përpunim të qumështit dhe mishit“	150,000 €	15 fermerë përfitues	Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Bujqësisë dhe Donatorët	Drejtoria e Bujqësisë, Bizneset	2021 - 2023
	6.1.7.3 „Ndërtimi dhe furnizimi me pajisje i mini podrumëve për përpunimin e rrushit“ (verëra dhe raki)	400,000 €	20 fermerë /biznese përfitues	Komuna dhe donatorët tjerë	Komuna	2021 - 2024
	6.1.7.4 “Themelimi i qendrave për grumbullim të pemëve dhe perimeve”	180,000 €	6 qendra grumbull. te themeluara	Komuna, Ministria dhe Donatorët	Fermerët dhe shoqatat e fermerëve	2022 - 2024
	6.1.8 Mekanizëm Bujqësor					
	6.1.8.1 „Furnizim me mekanizëm bujqësor“	300,000 €	100 fermerë përfitues	Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Bujqësisë	Komuna dhe Drejtoria e Bujqësisë	2021 - 2023
	6.1.9 Marketing					
	6.1.9.1 “Promovimi më i mirë i fermerëve në treg”	30,000 €	30 fermerë përfitues	Komuna, Ministria dhe Donatorët	Komuna dhe Shoqatat e Fermerëve	2021 - 2026
	6.1.9.2 “Organizimi i panairit vjetor bujqësor”	30,000 €	Rritja e promovimit të fermerëve	Komuna	Komuna dhe shoqatat e fermerëve	2021 - 2026
	6.1.10 Certifikim					
	6.1.9.3 “Aftësimi dhe certifikimi i fermerëve në standardet ndërkombëtare”	180,000 €	60 fermerë të certifikuar (10/vit)	Ministria dhe Donatorët	Fermerët dhe shoqatat e fermerëve	2021 - 2026
Gjithsej		3,890,000 €				

Veprimi 2

Objektivi	Kategoria dhe titulli i projektit	Vlera e	Rezultatet e	Burimet e financimit	Zbatuesit	Periudha e
-----------	-----------------------------------	---------	--------------	----------------------	-----------	------------

		projektit	pritshme			zbatimit
Zhvillimi i Turizmit	Dokumente strategjike					
	6.2.1.1 “Hartimi i planit strategjik zhvillimor të Turizmit (2021-2025)”	15,000 €	Krijimi i dokumentit bazë për zhvillim të turizmit	Komuna, Donatoret	Nënkontraktori	2021
	Infrastruktura					
	6.2.2.1 “Identifikimi dhe rregullimi i mullinjëve të vjeter ne Vraniç, Çadrak, Semetisht, Dragaqine”	100,000 €	Renovimi dhe preservimi i mullinjëve të identifikuar.	Komuna MTI Pronarët Donatorët	Komuna, Pronarët, Kompanitë kontraktuara	2022-2025
	6.2.2.2 “Identifikimi dhe aftësimi i shtëpive për bujtina potenciale”	100,000 €	Renovimi i 10 shtëpive rurale për bujtina, me bashkë financim. Gjetja e familjeve të interesuara për ofrim të shërbimeve të tilla.	Komuna MTI Pronarët Donatorët	Kompanitë kontraktuara, Pronarët përfitues	2021-2023
	6.2.2.3 “Hapja e rrugës malore bjeshka e Dellocit – Bukosh – Budakovë – Grejkoc”	300,000 €	Zhvillimi i Turizmit Malor, zhvillim ekonomik	Komuna dhe Donatoret	Komuna, Nënkontraktori	2021-2023
	6.2.2.4 “Hapja e shtigjeve dhe shenjëzimi në Delloc, Gradanc, Budakovë, Mushtisht, Grejkoc”	200,000 €	5 shtigje të kompletuara në komunë	Komuna dhe Donatoret	Komuna, Nënkontraktori	2021
	6.2.2.5 “Rregullimi infrastrukturës në Delloc për parking të kampshtëpizave”	500,000 €	Parkingu i kampshtëpizave i kompletuar me infrastrukturë përcjellëse.	Komuna dhe Donatoret	Komuna, Nënkontraktori	2021 - 2025

6.2.2.6 “Ndërtimi i rrugës Budakovë – Bukosh – Gradanc – Kabash”	5,250,000 €	Rruga malore rreth atraksioneve natyrore ndërtuar	Komuna dhe Donatoret	Komuna, Nënkontraktori	- 2026
6.2.3 Marketing					
6.2.3.1 “Hartimi i materialeve promovuese turistike”	4,000 €	Promovimi i turizmit përmes fletushkave, broshurave, stickers-ave.	Komuna	Nënkontraktori	2021
“Zhvillimi i webfaqes dhe promovimi i turizmit në rrjetet sociale”	1,000 €	Hartim të webfaqes në disa gjuhë dhe promovim në Facebook e Instagram, me foto nga pikat turistike.	Komuna	Nënkontraktori	2021
“Krijimi i qendrës informuese turistike digjitale në qytet”	30,000 €	Sigurimi i pajisjeve digjitale për orientimin e turistëve	Komuna, MTI, Donatoret	Nënkontraktori, Komuna	2021-2022
“Krijimi i një filmi dokumentar për turizëm në Suharekë”	5,000 €	Promovimi dhe rritja e vizibilitetit të turizmit në komunën tonë.	Komuna	Nënkontraktori	2023
6.2.3.5 “Themelimi i qendrës për promovimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore (Muzeu Turistik)”	100,000 €	Muzeu turistik i kompletuar, në kuadër të muzeut të qytetit	Komuna dhe Donatoret	Komuna	2021 -2023

	Ngritja e kapaciteteve humane					
	6.2.4.1 “Aftësimi i vendit për kamping veror tek “Gurra e kadisë”, Budakovë”	25,000 €	Vendosja e tavolinave të drurit dhe ulëseve, rregullim të shtigjeve në hapësirë prej 3 ha.	Komuna MTI Pronarët Donatorët	Nënkontraktori, Pronarët përfitues	2022
	6.2.4.2 “Aftësimi i 3 ciceronëve turistik në komunë”	5,000 €	3 ciceronë të aftësuar	Komuna dhe Donatoret	Komuna, Nënkontraktori	2021
	6.2.5 Grande					
	6.2.5.1 “Mbështetja e zhvillimit të artizanateve/suvenireve”	30,000 €	Artizanatet kryesore të identifikuar dhe të mbështetura	Komuna dhe Donatoret	Komuna	2022 - 2023
GJITHSEJ: 6,665.000 €						

Veprimi 3

Objektivi	Kategoria dhe titulli i projektit	Vlera e projektit	Rezultatet pritshme	Burimet e financimit	Zbatuesit	Periudha e zbatimit
Zhvillimi i Ndërmarrësisë	6.3.1 Dokumentacioni					
	6.3.1.1 “Ndërrimi i destinimit të agrozonës në zonë industriale”	/	Krijimi i kushteve për zhvillim të bizneseve dhe	/	Asambleja komunale	2021 - 2022

			rritje të punësimit			
6.3.2 Infrastruktura						
6.3.2.1 “Vendosja e tabelave informuese në zonën industriale”	13,000 €	Promovimi më i mirë i bizneseve të zonës	Komuna, Afaristet	Komuna dhe Nënkontaktori		2021
6.3.2.2 “Rregullimi i shiritave të gjelbërt në zonën industriale”	47,000 €	Infrastruktura e rregulluar në zonë	Komuna, Ministria e Tregtisë	Komuna dhe Nënkontaktori		2021
6.3.2.3 “Ndërtimi i inkubatorit të biznesit me showroom në zonën industriale”	120,000 €	Zhvillimi i bizneseve të reja dhe promovimi i atyre ekzistuese	Komuna dhe Donatorët	Komuna dhe bizneset		2022 - 2023
6.3.3 Grande						
6.3.3.1 “Lansimi i skemës së granteve për agro përpunim dhe deponim”	300,000 €	Mbështetja e bizneseve me pajisje të nevojshme	Komuna dhe donatorët	Komuna dhe bizneset		2021 - 2026
6.3.3.2 “Lansimi i skemës së granteve për mbështetje të bizneseve të reciklimit”	150,000 €	Sigurimi i pajisjeve për reciklim	Komuna dhe donatorët	Komuna dhe bizneset		2022 - 2023
6.3.4 Ngritja e kapaciteteve humane						
6.3.4.1 “Aftësimi i të rinjve për hartim të projekteve dhe menaxhim të biznesit”	20,000 €	Zhvillimi i bizneseve të reja, rritja e punësimit	Komuna dhe donatorët	Komuna dhe Nënkontraktori		2021 - 2026
6.3.5 Marketing						
6.3.5.1 “Organizimi i panairit vjetor”	15,000 €	Promovimi i bizneseve	Komuna dhe donatorët	Komuna		2021 - 2026
GJITHSEJ: 665,000 €						

Objektivi	Kategoria dhe titulli i projektit	Vlera e projektit	Rezultatet pritshme	Burimet e financimit	Zbatuesit	Periudha e zbatimit
	Kategoria					
Energjia ripërtëritshme dhe ambienti	6.4.1 Infrastruktura					
	6.4.1.1 “Investimet në energji diellore në shkolla”	500,000 €	Të gjitha shkollat e mesme dhe një pjesë e shkollave fillore të pajisura me panela diellor	Bashkësia Evropiane (Grantet për efikasitet), Donatorët tjerë	Komuna e Suharekës, Nënkontraktori	2021 - 2024
	6.4.1.2 “Ndriçimi publik me panela diellor”	500,000 €	Kursimi i energjisë përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtëritshme	Bashkësia Evropiane (Grantet për efikasitet), Donatorët tjerë	Komuna e Suharekës	2021 - 2023
	6.4.1.3 “Ndërtimi i liqenit artificial të Dragaqinës”	20,000,000 €	Ndikon në ujitjen e tokave bujqësore, krijim të zonave rekreative, ambient.	Banka Botërore, Donatorët tjerë	Qeveria e Kosovës	2024 - 2026
	6.4.1.4 “Ndërtimi i hidrocentralit në liqenin e Dragaqinës”	5,000,000 €	Ndikon në kursim të energjisë	Banka Botërore, Donatorët tjerë	Qeveria e Kosovës	2024 - 2026
	6.4.1.5 “Ndërtimi i turbinave të erës në Budakovë dhe Duhël (rreth 60 turbina)”		Ndikon në kursim të energjisë	Investitorë privat	Investitorë privat	2022 - 2024
	6.4.1.6 “Aplikimi i energjisë diellore në zona industriale”		Ndikon në kursim të energjisë	Investitorë privat	Investitorë privat	2022 - 2024
	6.4.1.7 “Rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumit”		Ruajtja e ambientit	Komuna, Ministria e Ambientit	Komuna, Nënkontraktori	2021 - 2026
	6.4.1.8 “Ndërtimi i argjinaturave”		Ruajtja e ambientit	Komuna, Ministria e Ambientit	Komuna, Nënkontraktori	2021 - 2026

6.4.1.9 “Ndërtimi i parqeve në zona rurale”	150,000 €	Ruajtja ambientit	e	Komuna	Komuna, Nënkontraktori	2021 - 2023
6.4.1.10 “Ndërtimi i 30 mini-impianeteve për trajtimin e ujrave të zeza”	510,000 €	Ruajtja ambientit	e	Komuna	Komuna, Nënkontraktori	2021 - 2023
6.4.1.11 “Krijimi i 20 rezervateve me ujë”	325,000 €	Ruajtja ambientit	e	Komuna	Komuna, Nënkontraktori	2022 - 2026
6.4.1.12 “Identifikimi dhe përgatitja e infrastrukturës për deponi të materialeve interte”	N/A	Ruajtja ambientit	e	Komuna	Komuna, Nënkontraktori	2021-2024
6.4.2 Marketing						
6.4.2.1 “Organizimi i fushatës së vetëdijesimit për ambientin dhe mbjellja e drunjve dekorativ”		Ruajtja ambientit	e	Komuna, Ministria e Ambientit, Donatorët	Komuna, Nënkontraktori	2021 - 2026
GJITHSEJ:						26,985,000 €

Grupi i punës

SZHEL e komunës së Suharekës është punuar nga grupi i punës, i përbërë nga:

1. Agim Bykygbashi, Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Buxhet
2. Fatos Kuqi, Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Buxhet
3. Driton Maliqaj, Drejtorja për Administratë
4. Sanie Kuqi – Rexhepaj, Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim
5. Jahir Tafaj, Drejtorja për Inspeksion
6. Avni Bytyqi, Zyra Ligjore
7. Nderim Bytyqi, Agjencia për Zhvillim Rajonal – Jug
8. Hajrush Suka, Drejtorja për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari
9. Xhemaili Aliu, Drejtorja për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari
10. Gani Sallauka, Qendra e Biznesit në Suharekë
11. Bedri Berisha, ERPK (Ekipi Rajonal i Projekteve Komunale)
12. Gent Gashi, ERPK (Ekipi Rajonal i Projekteve Komunale)
13. Ismet Krasniqi, NP “Eko-Regjioni” njësia në Suharekë
14. Latif Krasniqi, NP “Hidroregjioni” njësia në Suharekë

15. Naim Kicaj, BIOKS (Hartimi i projekteve bujqësore)
16. Ganimete Vata, OJQ “Gratë Fermere” Suharekë
17. Hamdi Bytyqi, Shkolla e Mesme Teknike “Skender Luarasi”
18. Destan Berisha, Shkolla e Mesme Profesionale “Avdyl Rama”

DRAFT